



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
MINISTRI

MIRATOHET

MINISTRI I
PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

SOKOL OLLDASHI

U D H Ë Z I M

Nr. 20, datë 16.10.2008

Për

Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë për Shërbimet e
Menaxhimit të Trafikut Ajror

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe Ligjit Nr 9658, datë 18.12.2006, për ratifikimin e "Marrëveshjes Shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe Shteteve të tij Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Mbi Krijimin e një Zone të Përbëshkët Evropiane të Aviacionit",

UDHËZOJ :

Hyrje

KAPITULLI 1

Të përgjithshme

1. Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të vendosë rregullat e zbatueshme për Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë për Shërbimet e Menaxhimit të Trafikut Ajror në zbatim të KRRSE3/ ESARR3, mbi Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë për Shërbimet e Menaxhimit të Trafikut Ajror.

2. Organet zbatuese

2.1 Ngarkohet DPAC, si organi i ngarkuar edhe me funksionet e AKM, të garantojë zbatimin e këtij Udhezimi.

2.2 DPAC do të mbikqyrë dhe do të garantojë zbatimin me përpikëri të rregullave të vendosura në këtë Udhezim, nga Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror.

2.3 Kërkesat e përgjithshme të këtij Udhezimi do të zbatohen nga departamentet e percaktuara të Aviacionit Civil, ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror dhe nga i gjithë personeli i shërbimit të menaxhimit të trafikut ajror (MTA), përgjegjës për detyrat, të cilat brenda janë percaktuar si të lidhura ngushtë me sigurinë.

2.4 Kërkesat do të zbatohen tek:

- departamentet e percaktuara të Aviacionit Civil, organizmat operative dhe individët e personelit, të cilët nepermjet pajisjeve të MTA të aprovuara për përdorim operacional, garantojnë shërbime.
- Autoritetet ushtarake dhe personeli i tyre që garantojnë shërbime për pajisjet MTA të aprovuara për përdorim operacional në një mjedis të përzier civilo-ushtarak, përveç kur ekziston një strukturë rregulluese inxhinierike ushtarake ekuivalente dhe e deleguar tek Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil.

3. Kërkesat e Sigurisë

3.1 Kërkesa të përgjithshme

Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil duhet të garantojë, përmes aplikimit të auditimeve dhe proceseve rregullatore përkatëse, që organizmat dhe personeli përgjegjës për detyrat në lidhje me shërbimin e trafikut ajror apo që mbulon fushën e shërbimeve të trafikut ajror, të cilat janë konsideruar të lidhura me sigurinë e trafikut ajror, ka zbatuar detyrat sic janë të percaktuara në këtë udhëzim.

3.2.1 Kërkesa të zbatuara nga DPAC

DPAC, është përgjegjëse që:

- a) të garantojë mbikqyrjen e përshtatshme dhe të mjaftueshme të rregullave të percaktuara si më.
- b) të kryejë, pas hulumtimit përkatës mbi një terren të pranueshëm, veprimin rregullues përkatës në përputhje me specifikimet e kësaj rregulloreje dhe me dispozitat e OSHNA.

3.2.2 Kërkesa të zbatueshme nga OSHNA.

OSHNA. do të:

- a) garantojë implementimin e detyrave që i lindin asaj në bazë të përcaktimeve të kësaj rregulloreje;
- b) garantojë që, në lidhje me procedurat e percaktuara nga rregullorja e më poshtëme, të dhënat që ekzistojnë, janë dokumentuar nga OSHNA, dhe vihen në dispozicion, me kërkesë të D.P.A.C.-së;
- c) garantojë që, nga një pikëpamje sigurie, metodat përkatëse të zgjedhura janë ato që duhen, për të garantuar plotësimin e dispozitave të zbatueshme të këtij Udhëzimi;

4. PËRJASHTIME

Ne rastin e ekzistencës së rrethanave që bëjnë të pamundur zbatimin e kërkesave të (KRRSE/ESARR) 1, DPAC do të bëjë vlerësimin e tyre dhe me pas do të publikojë zyrtarisht, një dokument përjashtimi, i cili do të garantojë një nivel ekuivalent sigurie.

5. Termat e përdorur

5.1 Termat dhe shkurtime të përdorura në këtë Udhëzim sqarohen në shtojcën A, bashkëlidhur këtij Udhëzimi dhe përbejnë pjesë integrale të tij.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KAPITULLI 2

Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë për Shërbimet e Menaxhimit të Trafikut

1. Përgjegjësia kryesore për sigurinë e shërbimit të MTA bie mbi ofruesin e shërbimit.
2. DPAC është përgjegjëse për të garantuar që ofruesit e shërbimit të MTA që operojnë brenda juridiksionit të tij, kanë ndërtuar, si një pjesë integrale të menaxhimit të shërbimit të trafikut ajror, një sistem menaxhimi sigurie (SMS). DPAC do të pranojë SMS dhe do të verifikojë vënien e tij në zbatim dhe operimin efikas në vazhdimësi nëpërmjet auditeve mbikqyrëse të sigurisë të kryera sipas procedurave përkatëse të Manualit të AKM, mbi Procedurat për Mbikqyrjen e Sigurisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror.
3. Një Ofrues i Shërbimeve të Navigimit Ajror duhet të krijojë:

Kërkesat e Përgjithshme për OSHNA

Një ofrues shërbimi MTA duhet të ndërtojë një sistem menaxhimi sigurie (SMS), i cili adreson të gjithë parimet e parashikuara në këtë udhëzim, dhe dokumenton strategjitë me anë të të cilave do të arrihen objektivat e përcaktuara të cilat i ka aprovuar DPAC-ja, dhe që janë si më poshtë:

Objektivat e Sigurisë janë:

3.1 Menaxhimi i sigurisë

- a. garanton përafrimin formal, të qartë dhe paraveprues për menaxhimin sistematik të sigurisë në përmbushjen e përgjegjësive brenda dispozitës së shërbimeve të MTA;
- b. mbulon të gjitha shërbimet në lidhje me MTA dhe shërbimet mbështetëse të cilat janë nën kontrollin e tij menaxherial;
- c. përfshin, si themelin e tij, një deklaratë të politikës së sigurisë që përcakton përafrimin themelor të organizatës për menaxhimin e sigurisë;

3.2 Përgjegjësia e Sigurisë

garanton që personat e përfshirë në aspektet e sigurisë të dispozitës së shërbimit të MTA kanë një përgjegjësi individuale sigurie për veprimet e tyre dhe që menaxherët janë përgjegjës për performancën e sigurtë të organizmave të tyre;

3.3 Prioriteti i Sigurisë

garanton që arritjes së një sigurie të kënaqshme në MTA duhet t'i jepet prioriteti më i lartë mbi presionet komerciale, operacionale, ambientaliste apo sociale;

3.4 Objektivat e Sigurisë së Shërbimit të MTA

garanton që gjatë kryerjes së një shërbimi MTA, objektivi kryesor i sigurisë është të minimizojë kontributin e MTA në rrezikun e një

aksidenti ajror për aq kohë sa është në mënyrë të arsyeshme i praktikueshëm.

4. Brënda funksionimit të SMS, një ofrues i shërbimit të MTA duhet të garantojë kërkesat e mëposhtëme për Arritjen e Sigurisë:

4.1 Kompetenca

Një OSHNA duhet të garantojë që stafi është trainuar mjaftueshëm, i motivuar dhe kompetent për punën që i është kërkuar të bëjë, përveç të qënurit i licencuar, nëse kërkohet;

4.2 Përgjegjësia mbi Menaxhimin e Sigurisë garanton:

- a. që një funksion mbi menaxhimin e sigurisë identifikohet me përgjegjësinë organizacionale për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë
- b. që kjo pikë e përgjegjësisë është, kudo ku është e mundshme, e pavarur nga linja e menaxhimit dhe përgjegjëse direkt tek niveli më i lartë organizativ
- c. që niveli më i lartë i organizatës së ofruesit të shërbimit luan një rol në garantimin e menaxhimit të sigurisë;

4.3 Nivelet Sasiore të Sigurisë

kudo ku praktikohen, nivelet sasiore të sigurisë janë përcaktuar dhe mirëmbahen për të gjitha sistemet sipas procedurave të (KRRSE/ESARR 4) ;

4.4 Vlerësimi dhe Minimizimi i Rrezikut

- a. vlerësimi dhe minimizimi i rrezikut kryhet në një nivel të përshtatshëm sipas procedurave të KRRSE/ESARR 4 dhe KRRSE/ESARR 6 për të garantuar që të gjitha aspektet e MTA, konsiderohen në mënyrën e duhur;
- b. ndryshimet e sistemit të MTA vlerësohen për shkallën e tyre të sigurisë dhe funksionet e sistemit të MTA klasifikohen sipas shkallës së rrezikshmërisë së tyre mbi sigurinë;
- c. vlerësimi dhe zbutja e rrezikut adreson jetëgjatësinë e plotë të pjesëve përbërëse të Sistemit të MTA, prej planifikimit fillestar dhe përcaktimit deri në operacionet pas implementimit, mirëmbajtjes dhe çmontimit të tyre;
- d. minimizimi përkatës i rreziqeve siguruhet atje ku vlerësimi i rrezikut e ka treguar këtë të jetë e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së sigurisë së ndryshimit;

4.5 Dokumentimi i SMS

OSHNA duhet të garantojë që SMS është dokumentuar sistematikisht në një mënyrë e cila jep një lidhje të qartë me politikën e sigurisë të organizatës.

4.6 Shërbimet e Jashtme

OSHNA duhet të garantojë që shërbimet e jashtme ofrohen në mënyrë të kënaqshme për sa i përket sigurisë së tyre, duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre të sigurisë brenda dispozitës së shërbimeve të MTA;

4.7 Ngjarjet e Sigurisë

OSHNA duhet të garantojë që ngjarjet teknike dhe operacionale të MTA-së të cilat konsiderohen të kenë implikim të rëndësishëm për sigurinë investigohen menjëherë , dhe veprimet e nevojshme korrigjuese të ndërmerren;

5. Kërkesat për Garantimin e Sigurisë

Brenda funksioneve të SMS, një ofruar shërbimi i MTA duhet të zbatojë kërkesat e mëposhtme për Garantimin e Cilësisë;

5.1 Inspektimet e Sigurisë

inspektimet e sigurisë kryhen si një veprim rutinë, për të rekomanduar përmirësime atje ku duhet, për të dhënë garanci menaxherëve të aktiviteteve të sigurisë brenda hapësirave të tyre dhe për të konfirmuar përputhje me pjesët e aplikueshme të SMS së tyre;

5.2 Monitorimi i Sigurisë

metodat duhet të përcaktohen në mënyrë që të nxirren ndryshimet e sistemeve ose operacioneve të cilat mund të sygjerojnë që një element po i përafrohet një pike tek e cila standartet e pranueshme të sigurisë nuk plotësohen më dhe që ndërmerret veprimi i duhur korrigjues;

5.3 Regjistrat e Sigurisë

Të dhënat e sigurisë mirëmbahen gjatë të gjithë funksionimit të SMS si një bazë për t'iu dhënë garanci sigurie të gjithë atyre që lidhen me të, përgjegjës për, apo në varësi të, shërbimeve të ofruara dhe për autoritetin rregullator të sigurisë;

5.4 Dokumentimi i Vlerësimit dhe Minimizimi i Rrezikut

rezultatet dhe konkluzionet e procesit të vlerësimit dhe minimizimit të rrezikut për një sistem të ri apo të ndryshuar sigurie të dokumentohen në mënyrë specifike dhe që ky dokumentacion ruhet gjatë gjithë jetës së sistemit;

6. Kërkesat për Promovimin e Sigurisë

Brënda funksionit të SMS, një ofruar i shërbimit të MTA duhet të garantojë kërkesat e mëposhtme për Promovimin e Sigurisë ;

6.1 Shpërndarja e Mësimeve të Nxjerra

mësimet e nxjerra nga investigimi i ngjarjeve të sigurisë dhe aktiviteteve të tjera të sigurisë përhapen gjerësisht brënda organizatës në nivelet e menaxhimit dhe operacionale;

6.2 Përmirësimi i Sigurisë duhet të sigurojë:

- a. që i gjithë stafi është aktivisht i inkurajuar për të propozuar zgjidhje për situatat e rrezikshme të identifikuara, dhe
- b. që ndryshimet janë bërë për të përmirësuar sigurinë atje ku ato janë shfaqur të nevojshme.

SHTOJCA A

1. TERMA dhe PËRKUFIZIME

Ne funksion te ketij Udhezimi termat e meposhtem nenkuptojne:

Autoriteti Kombëtar Mbikqyrës (AKM).	Eshtë ajo pjesë e DPAC-së e autorizuar nga ky Udhëzim i Ministrit të PPTT si organi kompetent i autorizuar për kryerjen e funksionit të mbikqyrjes së Sigurisë në nivel kombëtar, dhe të Shërbimeve të Trafikut Ajror.
DPAC – Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil	Autoriteti rregullator kompetent në varësi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe është përgjegjës për rregullat dhe rregulloret e sigurisë së aviacionit.
Shërbimet e Navigimit Ajror (SHNA)	– Shërbimet e trafikut ajror; komunikimi; shërbimet e navigimit dhe vëzhgimit, shërbimi meteorologjik i navigimit ajror; dhe shërbimin e informacionit aeronautik.
Ofruesit e SHNA	- Person ose organizatë, ose përfaqësues i përcaktuar nga një organizatë ,i cili është zbatues i rregulloreve të grupit i mbikqyrës të SHNA.
Manaxhimi i Trafikut Ajror (MTA)	Manaxhimi i Trafikut Ajror. Bashkësia e veprimtarisë në tokë (të përbërë nga ATS, ASM, ATFM) dhe ato funksione të avionit në ajër të nevojshme për të garantuar zhvendosjen e saktë të mjeteve fluturuese gjatë fazave përkatëse të operimit.
Shërbimi i Menaxhimit të Trafikut Ajror	Një organizatë përgjegjëse dhe e autorizuar për të siguruar dhe kryer shërbime të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA).

**Ofruesi i shërbimeve MTA
Shërbimi i Trafikut
Ajror (SHTA)**

Një shërbim në funksion të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA).

**Shërbimi i Kontrollit të Trafikut
Ajror (KTA)[**

Një term i përgjithshëm që përmbledh shërbimet e ndryshme të informacionit mbi fluturimin, shërbimin e sinjalizimit, shërbimi konsultativ i trafikut ajror, shërbimi i kontrollit të trafikut ajror (i kontrollit të ajrit, kontrollit të afrimit apo të kontrollit të aerodromit)

Kërkesat e Përbashkëta

Një shërbim i siguar për qëllimin e:
a) parandalimit të përplasjeve :
1) midis avionave dhe
2) midis avionit dhe objekteve penguese mbi zonën e manovrimit dhe
b) lehtësimit, mbarëvajtjes së saktë dhe menaxhimit të fluksit të trafikut ajror
Kërkesa të Rregullores së (KE) që duhet të përmbushë një Ofrues SHNA që të çertifikohet në ofrimin e shërbimit.

Nje Qiell i Vetëm European (QVE)

Një koncept dhe paketë rregulloresh mbështetëse për operim të zbutur në sistemet e trafikut ajror ndërlidhur me pajtueshmërinë, nivelin e lartë të sigurisë në shërbimet navigacionale ajrore për mundësimin e përdorimit optimal të hapësirës ajrore Evropiane dhe pajtushmërine, nivelin e lartë të sigurisë në udhëtimet ajrore ,duke ju përmbytur interesave të përgjithshme të shërbimeve navigacionale ajrore, përfshirjen e detyrimeve për shërbimin publik. Ofrimi i shërbimit duhet të zbatohet me standartet më të larta të përgjegjesisë dhe kompetencës.

Realizimi i sigurisë

Rezultati i procesit dhe/ose metodat e aplikuar për të arritur siguri të pranueshme ose të tolerueshme.

Objektivi i sigurisë

Një objektivi i sigurisë është një synim i planifikuar i sigurisë. Realizimi i një objektivi mund të jetë demonstruar nga mjetet përkatëse të përcaktuara në përputhje me rregulloren e sigurisë.

Kërkesa mbi sigurinë

Një mjet i zbutjes së rrezikut, i përcaktuar prej strategjisë së zbutjes së rrezikut që arrin një **Objektiv Sigurie** të caktuar. Kërkesat e sigurisë mund të marrin forma të ndryshme, duke përfshirë kërkesa organizative, operacionale, procedurale, funksionale, ekzekutimi dhe ndërvepruese apo karakteristika mjedisore.

ESARR

EUROCONTROL Safety Regulatory Requirement (Kërkesat Rregullatore të Sigurisë të Eurokontrollit).

Niveli i Sigurisë (Level of Safety)

Një nivel që tregon se sa siguri është ushtruar, vlerësuar në një kontekst të dhënë, duke iu referuar një rreziku të pranueshëm apo të tolerueshëm.

Rregullore

Përvetësimi, dekretimi dhe vënia në zbatim i rregullave për arritjen e objektivave të shpallura nga ata tek të cilët aplikohet procesi rregullator.

Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS)

Një trajtim sistematik dhe i hollësishëm që përcakton aktivitetet me anë të të cilave menaxhimi i sigurisë është ndërmarrë nga një autoritet i emëruar në mënyrë që të arrihet siguria e pranueshme dhe e tolerueshme.

Mbikqyrja e Sigurisë

Funksioni i ndërmarrë nga autoriteti i emëruar AKM për të verifikuar që objektivat e rregullores së sigurisë janë arritur dhe kërkesat e saj janë përmbushur me efikasitet

Kreu i AKM

Kreu i Mbikqyrjes së SHNA ose përfaqësuesi i përcaktuar i tij për një procedurë të posaçme.

Auditimi i rregullave të Sigurisë

Një ekzaminim sistematik dhe i pavarur kryer nga AKM për të përcaktuar nëse përmbushen rregulloret ose elementë të tjerë në lidhje me sigurinë, për proceset rezultatet e tyre ose shërbimet, nëse përputhen me marrëveshjet në lidhje me sigurinë dhe nëse janë të implementuara efektivisht dhe janë të arritshëm rezultatet e pritura.

Kërkesë-Rregullorja e Sigurisë

Çertifikata e Kompetencës/Kompetenca

Kushti zyrtar i caktuar nga rregullatori i sigurisë i lidhur me specifikimin, i cili nëse pajtohesh me të, do të të çojë drejt njohjes dhe respektimit të kompetencës së sigurisë.

[Ref.: ICAO Annex 1]

Një shprehje e përdorur në ESARR 5 me të njëjtin kuptim si “çertifikata e kompetencës dhe liçencës”, “liçencë ose çertifikatë” dhe “liçencë” e përdorur në ICAO Annex 1 dhe Konventën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

2. SHKURTIME

Shkurtime e perdorura ne kete udhezim kane kuptimet si meposhte:

1. AKM - Autoriteti Rregullator Kombëtar
2. SHNA - Shërbimi i Navigimit Ajror
3. OSHNA - Ofruesit e Shërbimit të Navigimit Ajror
4. SHTA - Shërbimi i Trafikut Ajror
5. SHKTA - Shërbimi i Kontrollit të Trafikut Ajror
6. KTA - Kontrolli i Trafikut Ajror
7. KE - Komisioni Evropian
8. DPAC - Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil
9. ANTA sh.a. - Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror
10. MTA - Menaxhimi i Trafikut Ajror
11. ECAC - European Civil Aviation Conference
12. PITSHTA - Personeli Inxhiniero –Teknik i SHTA
13. PIT - Personel Inxhiniero-Teknik
14. AL - Autoriteti i Liçensimit
15. VPSS - (PSSA) Vlerësimi Paraprak i Sistemeve të Sigurisë.
16. KNS - Komunikim, Navigim dhe Survejim
17. VSS - (SSA) Vlerësimi i Sigurisë së Sistemeve
18. VFR - (FHA) Vlerësimi Funkcional i Rrezikut